

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-129/13

Prishtinë, 3 Qershor

2015

Në çështjen juridike të:

D S

P 41

S

S

Pala ankuese

Kundër

Trashëgimtarëve të H Ç

Palët përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) nr. KPCC/D/A/180/2012 të datës 14 Dhjetor 2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA08461), po ashtu në tekstin e mëtejme: Vendimi i KKPK-së, pas shqyrtimit të mbajtur më 3 Qershor 2015, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e **D S** kundër Vendimit të **KKPK-së** nr. **KPCC/D/A/180/2012**, të datës 14 dhjetor 2012.

2. Vërtetohet vendimi i KKPK-së KPCC/D/A/180/2012 sa i përket kërkesës nr. KPA08461.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 11 janar 2007 D (L) S (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) në cilësinë e tij si anëtar i familjes së ngushtë të D S (e lindur Dj) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës pronësore të nënës së tij D S mbi dhe ri-posedimin e një ngastre toke në Gladnica pored puta në Petrovë, komuna Prizren, zona kadastrale Petrovë, numër 291/2, me sipërfaqe prej 00.04.20 ha tokë jopjellore dhe 00.09.76 tokë e punueshme e klasit të tretë (total: 00.13.96 ha) (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar).
2. Pala ankuese dorëzoi *inter alia* në AKP:
 - Fletën poseduese nr. 46, Zona Kadastrale Petrovë, të datës 8 maj 1984; sipas kësaj liste D S ka qenë pronare e pronës së kërkuar;
 - Një dokument që duket se është një aktgjykim i Gjykatës Komunale/të Qarkut të Prizrenit, të datës (me gjasë) 10-VI-1986, nr. 342/86, palët: D S dhe H C /H Č ;
 - Një dokument që duket se është një aktgjykim i Gjykatës Komunale/të Qarkut të Prizrenit, të datës (me gjasë) 3-4-1986, nr. 234/86.
3. Sipas certifikatës së vdekjes, të datës 27 prill 2015, D S ka vdekur më 6 korrik 2008.
4. Sipas një Raporti të Njoftimit, të datës 2 tetor 2008, AKP-ja e kishte përcaktuar vendndodhjen e pronës së kërkuar dhe e kishte gjetur të uzurpuar nga F Č .
5. F Č nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes në procedurën e kërkesës më 2 tetor 2008. Ai theksoi se pretendon të drejtë ligjore ndaj pronës së kërkuar.
6. Më 16 tetor 2008 H Č dërgoi Formularin e përgjigjes ndaj AKP-së. Ai deklaroi në këtë formulat se pronën e kishte blerë nga familja S në vitin 1970.
7. Ai dorëzoi *inter alia* me përgjigjen e tij një dokument të titulluar 'Kontrata e Përkohshme e Blerjes (dhe shitjes)'. Sipas tekstit, kontrata ishte lidhur ndërmjet M S dhe H Č /H Č në vitin 1970

dhe ka qenë për një fushë prej 54 ari, klasa e tretë, me lokacion në Petrovo Selo, Gladnica pranë rrugës.

8. Sipas certifikatës së vdekjes të datës 29 prill 2015, H Ć ka vdekur më 17 korrik 2010.
9. Me anë të letrës, të datës 20 qershor 2011, pala ankuese reagoi ndaj kësaj përgjigjeje. Ai thekson se ai është pasardhësi ligjor i nënës së tij D S . Ai konteston se pronë e kërkuar ka qenë ndonjëherë objekt i blerjes apo shitjes. Ai deklaron se H Ć kishte lidhur kontratë me njerkën e babait të tij të ndjerë për hisen e saj në ngastrën e tokës. Më vonë, ngastra ishte ndarë dhe nëna e tij ishte bërë pronarja e vetme e pronës së kërkuar, pjesa jo e shitur e ngastrës së tokës.
10. Sipas Raportit të Njoftimit, të datës 20 shkurt 2012, dhe Konfirmimit të pronës së njoftuar, të datës 23 shkurt 2012, AKP-ja e njoftoi pronën e kërkuar për herë të dytë dhe e gjeti pronën e kërkuar të uzurpuar nga anëtarët e familjes Ć . AKP-ja po ashtu e njoftoi kërkesën për Afrim Ć .
11. A Ć nënshkroi më 20 shkurt 2012 një njoftim tjetër të pjesëmarrjes në procedurën e kërkesës dhe pretendoi se kishte të drejtë ligjore mbi pronën e kërkuar.
12. Gjatë procesit të verifikimit të dokumenteve sipas detyrës zyrtare, AKP-ja gjeti një Çertifikatë për të drejtat e pronës së paluajtshme të datës 24 shkurt 2011. Sipas kësaj certifikate D S është pronare/poseduese e pronës së kërkuar.
13. AKP-ja e kontaktoi palën ankuese më 10 prill 2012. Sipas raportit të kësaj bisede, pala ankuese deklaroi se nëna e tij kurrë nuk e kishte shitur pronën e kërkuar dhe se pronë e kërkuar kishte qenë objekt i procedurës gjyqësore në Gjykatën Komunale dhe të Qarkut të Prizrenit në vitin 1986. Ai po ashtu pranoi se familja Ć e kishte shfrytëzuar pronën e kërkuar që prej viteve 1970-ta apo 1980-ta.
14. KKPK-ja vendosi në Vendimin e saj që kërkesën ta hedh poshtë. Për arsyetim rreth kësaj kërkeje, KKPK-ja i referohet vendimit të vërtetuar në paragrafët 11 dhe 18 të vendimit grupor. Në arsyetimin e saj, për aq sa është relevante, KKPK-ja deklaroi se bazuar në dokumentet e dorëzuara apo të siguruar sipas detyrës zyrtare, apo deklaratat e paraqitësit të kërkesës, paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur të tregojë se kërkesa përfshin rrethana që drejtpërdrejt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i periudhës 1998-1999.
15. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 8 maj 2013 dhe B Ć më 3 maj 2013.

16. Pala ankuese më datën 15 maj 2013 paraqiti ankesë kundër vendimit të KKKP-së të datës 10 maj 2013 (e pranuar në atë datë në Zyrën Pronësore të UNHCR-së) dhe e pranuar nga AKP-ja më 20 maj 2013. Ankesa iu dorëzua B Ć më 6 shtator 2013.
17. Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka marrë pjesë në procedurën e apelit para Gjykatës Supreme.
18. Gjykata Supreme dërgoi një Urdhër Gjykate, të datës 13 mars 2015 në AKP, palës ankuese dhe H Ć apo anëtarëve të interesuar të familjes së tij.
19. Urdhri i Gjykatës lexon si në vijim:

Ku në këtë urdhër thuhet prona e pretenduar, nënkuptohet: ngastra në zonën kadastrale Petrovë (Selo)/Petrovo Selo – Prizren, nr. 291/2, në sipërfaqe: 4.20 ar, tokë djerrinë dhe 9.76 ar, arë e punueshme, në total: 13.96 ari, e cila është ngastra e nënkuptuar në Fletën Poseduese Nr. 46, vendi: Gladnica/Pored Puta;

Agjencia Kosovare e Pronës brenda tri javësh nga pranimi i këtij urdhri të qartësoj si vijon:

Agjencia Kosovare e Pronës kërkohet që të verifikoj Aktgjykimin e Gjykatës Komunale/Qarkut në Prizren, të datës (ndoshta) 10-VI-1986, nr. 342/86, me palë: D S dhe H C /H Q , si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale/Qarkut në Prizren, të datës (ndoshta) 3-4-1986, nr. 234/86 dhe të i siguroj Gjykatës Supreme kopjet e lexueshme dhe përthimin në gjuhën Angleze dhe Shqipe të originalëve (këto aktgjykime gjenden në faqet 018-027 të lëndës së AKP-së). Gjykata mund të ia siguroj AKP-së kopjet e këtyre faqeve nëse nevojitet dhe kërkohet.

Kërkohet prej Agjencisë Kosovare të Pronës që të siguroj informacione nga Kadastrri se kur dhe se si është krijuar prona e pretenduar? A është krijuar kjo ngastër në/pas vitit 1970 si rezultat i ndarjes në mes M S dhe D S ?

Për të dy palët, D S dhe H Q (apo tani anëtari tjetër i familjes i interesuar):

Palët duhet të japin përshkrimin e hollësishëm të mbështetur me prova për si vijon:

- a. Kush e ka poseduar pronën e pretenduar gjatë periudhës së konfliktit të armatosur në mes të 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999,

b. Për çka është përdorur prona e pretenduar në këtë periudhë, dhe

c. Nëse e kanë humbur posedimin e pronës së pretenduar, kur dhe se si ka ndodhur.

Për palën ankuese, D S:

Parashtruesi i ankesës duhet të deklaroj, duke u mbështetur në prova, si vijon:

a. Kur ka vdekur D S (të sigurohet prova: certifikata e vdekjes);;

b. Kush është trashëgimtar, posaçërisht i pronës së pretenduar, i D S (të sigurohen prova, nëse ka mundësi aktvendimi i trashëgimisë).

H Q (apo tani anëtari tjetër i familjes i interesuar) të përgjigjet në pyetjet e mëposhtme, duke i mbështetur me prova:

A është H Q akoma gjallë apo ka vdekur?

Nëse H Q ka vdekur:

a. Kur ka vdekur (prova: certifikata e vdekjes);

b. Kush është trashëgimtar, posaçërisht i pronës së pretenduar, të H Q (të sigurohen prova, nëse ka mundësi aktvendimi i trashëgimisë) apo kush pretendon tani se e ka të drejtën e pronësore ndaj pronës së pretenduar;

c. Kush e merr pozitën e përgjegjës në ankesë në këtë procedurë.

Brenda 3 (tri) javësh nga pranimi i këtij urdhri.

Palët udhëzohen se dështimi për t'iu përgjigjur këtij urdhri brenda kësaj periudhe mund të shpie në një aktgjykim nga Gjykata Supreme, bazuar në informatat dhe provat në dispozicion, pa i pyetur palët më tutje.

20. AKP-ja u përgjigj më 27 prill 2015, se AKP-ja nuk ka mundur t'i verifikojë aktgjykimet e në fjalë dhe se aktgjykimet nuk ka qenë e mundur të përkthehen sepse ato janë të palexueshme. Sipas zyrtarit të verifikimit të AKP-së në Gjykatën Themelore të Prizrenit nuk ishin gjetur kopjet e aktgjykimeve që pala ankuese i ka dorëzuar në AKP dhe se lëndës i është caktuar një numër i ri i lëndës (eventualisht 404/89) dhe se lënda ende duhet të jetë në pritje. AKP-ja, në reagimin ndaj çështjes së dytë, dërgoi një certifikate nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, të datës 7 prill 2015. Sipas kësaj certifikate, të dhënat kadastrale ishin krijuar më 12 qershor 2012 dhe prona e kërkuar është ende në emër të D S si pronare/poseduese.
21. Pala ankuese u përgjigj më 29 prill 2015 duke dorëzuar një certifikate të vdekjes për D S , sikurse ceket në paragrafin nr. 3.
22. B Ć dërgoi një përgjigje, të datës 29 prill 2015 dhe të pranuar nga AKP-ja më 29 prill 2015. Ai dorëzoi certifikatën e vdekjes për H Ć , sikurse ceket në paragrafin nr. 8 dhe deklaroi se për aq sa relevante se prona e kërkuar ishte blerë nga pronari në vitin 1970, se shtëpitë ishin ndërtuar në pronën e kërkuar dhe ka aktgjykime të Gjykatave Komunale dhe të Qarkut në Prizren. Ai më tej thekson se prona e kërkuar nga 27 shkurti 1998 deri më 20 qershor 1999 ishte shfrytëzuar nga H Ć për ndërtimin e shtëpisë dhe oborrit.

Pretendimet e palëve

23. Pala ankuese pretendon në ankesë se ai është trashëgimtari ligjor i D S . Ai deklaron se ka treguar se prona e kërkuar nuk ishte humbur për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e vitit 1998/1999. Ai konteston se prona e kërkuar ishte shitur.

Arsyetimi ligjor:*Meritat e ankesës*

24. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji UNMIK 2006/50) KKPK-ja ka kompetencë që t'i zgjidh kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin sa i përket pronës së paluajtshme private, përfshirë pronës bujqësore, që përfshinë rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejtë me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
25. KKPK-ja arsyetoi se kërkesa në këtë lëndë nuk ndërlidhet me konfliktin e armatosur. KKPK-ja e ka bazuar këtë konkludim në pretendimin e palës përgjegjëse në ankesë se prona e kërkuar ishte blerë në vitin 1970 nga familja Č dhe e shfrytëzuar nga ta gjatë konfliktit. KKPK-ja po ashtu mori parasysh se pala ankuese konfirmoi para AKP-së se familja Č e kishte shfrytëzuar pronën e kërkuar që nga vitet 1970-ta dhe 1980-ta (shih paragrafin nr. 13 këtu).
26. Në reagimin ndaj Urdhrit të Gjykatës, pala ankuese nuk ka argumentuar se është e pavërtetë që familja Č në fakt e ka poseduar pronën e kërkuar që para dhe gjatë konfliktit të armatosur.
27. Se familja Č veç e kishte shfrytëzuar pronën e kërkuar para konfliktit të armatosur rezulton edhe nga pretendimet nga të dyja palët dhe konstatimet e AKP-së se që në vitin 1986 një lëndë ishte në pritje në Gjykatën në Prizren ndërmjet palëve për pronën e kërkuar.
28. Prandaj, Gjykata Supreme konkludon me KKPK-në se kërkesa nuk ndërlidhet me rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur, dhe KKPK-ja në mënyrë të ligjshme të vendosur se ajo nuk ka juridiksion për të vendosur rreth kërkesës. Prandaj, KKPK-ja në mënyrë të ligjshme vendosi ta hedhë kërkesën poshtë.

Konkludim

29. Rrjedhimisht, në përputhje me nenin 13.3 të Ligjit UNMIK 2006/50, Gjykata Supreme vendosi sikurse ne dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

30. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit UNMIK 2006/50 ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Nënshkruar nga: Urs Nufer, Referent i EULEX-it